



Datë: 18.07.2025
Numër Protokolli: 4906/2025

A.nr.997/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.997/2025, të datës 28.05.2025, të parashtruar nga ankuesja M.H, grup ankuesish kundër organit të punësimit: Kuvendi i Republikës së Kosovës në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa më A.nr.997/2025, e datës 28.05.2025, e parashtruar nga ankuesja M.H, L.G, D.Gj, B.E, L.A, M.A, F.J, A.D, I.A, F.S, E.E, N.A, C.I, E.G, A.S, S.Xh S.D, A.V, S.M, grup ankuesish.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, M.H, L.G, D.Gj, B.E, L.A, M.A, F.J, A.D, I.A, F.S, E.E, N.A, C.I, E.G, A.S, S.Xh S.D, A.V, S.M, (me tej referuar vetëm ankuesit), më datë 28.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.997/2025, lidhur me kompensimin për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare, lidhur me seancat plenare të mbajtura nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 19.04.2025, 27.04.2025, dhe 21.04.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 02.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 10.06.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A. Nr.3570/2025 të datës 28.05.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi për M.H, nga Grup ankuesit; Kopje e letërnjoftimit për M.H;Kopje e letërnjoftimit për L.G, Kopje e letërnjoftimit për D.G, Kopje e letërnjoftimit për B.E, Kopje e letërnjoftimit për L.A M.A, Kopje e letërnjoftimit për F.J, Kopje e letërnjoftimit për A.D, Kopje e letërnjoftimit për I.A, Kopje e letërnjoftimit për F.S, Kopje e letërnjoftimit për E.E, Kopje e letërnjoftimit për N.A, Kopje e letërnjoftimit për C.I, Kopje e letërnjoftimit për E.G, Kopje e letërnjoftimit për A.S, Kopje e letërnjoftimit për L.L, Kopje e letërnjoftimit për S.M, Kopje e letërnjoftimit për A.V; Kërkesë me numër protokolli 1133/25002, e datës 29.04.2025; Emali i datës 08.05.2025, dërguar nga M.H, për A.L; Emali i datës 13.05.2025, dërguar nga A.L, për Sh.G; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025, dërguar përmes emalit nga R.K, për M.H; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 997/2025, e datës 10.06.2025; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 100/2001, i datës 10.10.2023, për M.H; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Lartë i Komisionit Parlamentar”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 115/2001, i datës 10.10.2023, për L.G; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar Administrativ”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 312/2016, i datës 10.10.2023, për D.GJ; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Lartë për UEB”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 331/2018, i datës 10.10.2023, për B.E; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Koordinator i Njësisë për Marrëdhënie me Publikun”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 097/2005, i datës 10.10.2023, për L.A; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “ Zyrtar i Lartë për Shërbimin e deputeteve”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 127/2001, i datës 10.10.2023, për M.A; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar Administrativ”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 302/2015, i datës 10.10.2023, për F.J; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar Administrativ i Kontrollit dhe Mirëmbajtjes”, Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 129/2002, i datës 10.10.2023, për A.D; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar Administrativ”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 128/2002, i datës 10.10.2023, për I.A; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar Administrativ”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 152/2003, i datës 10.10.2023, për F.S; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Asistent Teknik”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 145/2002, i datës 10.10.2023, për E.E; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Asistent Teknik”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 342/2019, i datës 10.10.2023, për N.A; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 048/2001, i datës 10.10.2023, për C.I; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “ Zyrtar i lartë për media”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 121/2001, i datës 10.10.2023, për E.G; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Administrator për TI”; Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 046/2004, i datës 10.10.2023, për A.S; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “ Zyrtar i Lartë për Protokoll”; Lista e ankuesve e hyrje dalëve për grup ankuesit; Listat e pagave për muajin prill të viti 2025, për Grup ankuesit; Vendimi me numër protokolli 509, i datës 14.06.2023, i nxjerr nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka gjetur së ankesa është e pabazuar, sepse: Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesja **M.H**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr.100/2001, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën “Zyrtare e Lartë për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare”, Drejtorja për Mbushjen e Komisioneve Paralajmëtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesja **L.G**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 115/2001, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën” Zyrtare Administrative”, Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesi **D.Gj** sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 316/2016, i datës 10.10.2023, është i punësuar në pozitën” Zyrtar i Lartë për UEB”; ankuesi **B.E**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 331/2018, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën” Koordinator i Njësisë”; ankuesja **L.A**, sipas Akt

Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 097/2005, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Zyrtares e Lartë për Shërbimin e Deputeteve’, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, **M.A**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 127/2001, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘Zyrtares Administrative’, Drejtoria për Shërbime Teknike, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesi **F.J**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 302/2015, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘Zyrtar Administrativ i Kontrollit dhe Mirëmbajtës’, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesi **A.D** sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 192/2002, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Zyrtar Administrativ’, Drejtoria për Shërbime Teknike, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesi **I.A**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 128/2002, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Zyrtar Administrativ’ Drejtoria për Shërbime Teknike në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesi **F.S**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 152/2003, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Asistent Teknik’, Drejtoria për Shërbime Teknike në Kuvendin e Republikës së Kosovës, , ankuesi **E.E** sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 145/2002, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Asistent Teknik’, Drejtoria për Shërbime Teknike në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesja, ankuesja **N.A**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 342/2019, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Zyrtare e lartë për media’, ankuesja **C.I** sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 048/2001, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Zyrtare e lartë për media’, ankuesja **E.G**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 121/2001, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘Administrator i TI’ Drejtoria për Teknologji Informative, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, **A.S**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 046/2004, i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘Zyrtare e Lartë për Protokoll’, Drejtoria për Marrëdhënie dhe Protokoll, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, **S.Xh**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 215/2011 , i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘Zyrtare për Publikime’, Drejtoria për Marrëdhënie me Publikun, **S.D**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 018/2004 , i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘Koordinator i Njësisë ’ Drejtoria për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Protokoll, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesja **A.V**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 018/2002 , i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Zyrtare Administrativë’, Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ankuesja **S.M**, sipas Akt Emërimi me numër protokolli AE. Nr. 116/2001 , i datës 10.10.2023, është e punësuar në pozitën ‘ Zyrtare Administrativë’ Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Tutje, grup ankuesit me datën 29.04.2025 me kërkesë i janë drejtuar Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me kompozimin për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare, lidhur me seancat plenare të mbajtura nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 19.04.2025, 27.04.2025, dhe 21.04.2025, me arsyetim se grup ankuesit kanë punuar në fundjavë dhe ditët e festave zyrtare, ndërsa Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes emailit të datës 13.05.2025, i përgjigjet në kërkesën e datës 29.04.2025, ku përmes këtij emali Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, aprovon kërkesën për pushim për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare, për periudhën që lidhet me mbajtjen e seancave konstituive me vazhdimet e saj përgjatë muajit prill të vitit 2025, si dhe vazhdimin që është duke ndodhur edhe në muajin maj të vitit 2025, duke e obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të verifikoj evidencën e hyje daljeve për të gjithë nëpunësit Civil, të cilët kanë punuar gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare, dhe ti behët kompensim më ditë të pushimit të cilët duhet të shfrytëzojnë deri në përfundim të vitit 2025.

Ankuesja M.H, grup ankuesit të pakënaqur me përgjigjen e datës 13.05.2025, të nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me datë 28.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjegjës së dates 13.05.2025, të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me pretendimet ankimore se në përgjigjen e dhënë është aprovuar kërkesa për pushim për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare, ndërsa kërkesa e jonë ka qenë që të behët kompensimi me vlerë monetare në pajtim me dispozitat Ligjore në fuqi, Ligjin për Pagat e Sektorit Publik.

Nga administrimi i shkresave të lendes Kolegji i Këshillit, konstaton së nëpunësit civil të punësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës i realizojnë shtesat mbi pagën bazë sipas Rregullores Nr. 08-0008, për Shtesat dhe Kompensimet mbi Pagën Bazë, të Nëpunësve Civil të Administratës së Kuvendit të Kosovës të Republikës së Kosovës, sipas nenit 4, ku thuhet se; *Shtesat mbi pagën bazë i Takon nëpunësit të Administratës, bazuar në natyrën specifike të punës së Administratës së Kuvendit në mbështetje të punës së Trupave punës të Kuvendit , që kërkon funksionim efektiv të të gjitha shërbimeve në kohë dhe me përgjegjësi, punë nen presion kohor punë me orar të zgjatur dhe të pa parashikuara, si dhe kufizim në shfrytëzimin e pauzës ditore dhe të pushimit vjetor, për angazhim në vlerën prej 30%, ë pagës bazë*, prandaj me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë lidhur me realizimin e shtesë në pagë në vlerën prej 30%, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe listat e pagave të ankueseve dhe nga listat e pagave për muajin maj të vitit 2025, konstatohet së ankuesja **M.H**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesja **L.G**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **D.Gj**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **B.E**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesja **L.A**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesja **M.A** realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **F.J** realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **A.D** realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, Ankuesi **I.A**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **F.S** realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **E.E** realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesja **N.A**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesja **C.I**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **E.G**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesja **A.S**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesja **S.Xh**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, ankuesi **S.D**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30% ankuesja **A.V** realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%, dhe ankuesja **S.M**, realizon shtesën në pagën bazë me shumën prej 30%.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ju referua dispozitave të Ligjit nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik përkatësisht nenit 36, paragrafit 1 dhe 2, nen paragrafi 2.3, ku përcaktohet se; *1. Zyrtaret/ët publik/e dhe kategoritë e tjera të të punësuarave/ëve që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht funksionareve/ëve publik/e përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare.* 2. *Kompensimi sipas paragrafit 1. të këtij neni paguhet në përqindje të pagës bazë sipas ligjit përkatës për punë, si më poshtë: 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit*, ndërlidhur me nenin 13, të Ligjit nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, ku përcaktohet se; *Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji*, prandaj në rastin konkret Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim se ankuesit e realizojnë shumën prej 30%, të pagës bazë dhe pretendimi ankimor i ankuesve është i pa bazuar sepse sipas dispozitave ligjore në fuqi, se grup ankuesit të punësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak të natyrës së punës që kryejnë, realizojnë shtesa mbi pagën bazë. shumën prej 30%, të pagës bazë, andaj pretendimi ankimor i grup ankueseve është i pa bazuar në ligj.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 997/2025

Rushit Kajtazi

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësues së autorizuar të ankueseve M.H;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Njësisë për Burime Njerëzore në Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së